



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Ae.nr.281/2019

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Mahir Tutuli, kryetar i kolegjit, Liridon Maloku dhe Rustem Thaqi, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike të paditësit NTNP ["S..."] sh.p.k., me seli në Preshevë – Republika e Serbisë, të cilën me autorizim e përfaqëson [E.Q], avokat nga Presheva, kundër të paditurës ["N..."] sh.p.k., me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit [A.O], avokat nga Prishtina, me objekt kontesti kthim i mjeteve, në shumën e përgjithshme prej 20,000.00€, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës, të paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Ekonomike, EK.nr.283/2018, të datës 14.05.2019, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 02.04.2021, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e të paditurës ["N..."] sh.p.k., me seli në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Ekonomike, EK.nr. 283/2018, të datës 14.05.2019, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e atakuar e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses NTNP ["S..."], me seli në Preshevë – Republika e Serbisë, ku në piken I të dispozitivit të aktgjykimit është detyruar e paditura ["N..."] sh.p.k., me seli në Prishtinë, që në emër të kthimit të mjeteve paditëses t'ia paguaj shumën prej 10,000.00€ me kamatë prej 8% në vit e cila fillon të rrjedhe nga data e paraqitjes së padisë në gjykatë dt.31.03.2015 e deri në pagesën definitive që të gjitha brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi. Ndërsa në piken II të dispozitivit është refuzuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit NTNP ["S..."], me seli në Preshevë – Republika e Serbisë si e pabazuar, e paraqitur kundër të paditurës ["N..."] sh.p.k, me seli në Prishtinë me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura që t'ia ktheje shumën e mjeteve prej 10,000.00€ në emër të mos përmbushjes së marrëveshjes për shitjen e "S..." me numër të motorit ... dhe me numër identifikues ... viti i prodhimit 2006. Dhe në piken III të dispozitivit është detyruar e paditura që paditësit t'ia paguaj shumën prej 390,00€ brenda afatit kohor prej 7 ditësh nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimi, në emër të kompensimit të shpenzimeve të procedurës kontestimore.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë edhe pala e paditur ["N..."] sh.p.k., me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të

procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që Gjykata Apelit ta aprovoje në tërësi ankesën e përfaqësuesit të përkohshëm të paditurës si të bazuar dhe ndryshohet aktgjykimi EK.nr. 283/2018, të datës 14.05.2019 ashtu që refuzohet në tërësi padia dhe kërkesëpadia e paditëses për pagimin e borxhit në shumën prej 20,000.00€ si dhe të gjitha shpenzimet e shkaktuara të procedurës ti barte paditësja.

Përgjigje në ankese nuk ka.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, e pas vlerësimit të tyre në bazë të nenit 194 të LPK-së , gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi NTNP ["S..."], me seli në Preshevë – Republika e Serbisë me datën 31.03.2015 ka paraqitur padi, kundër të paditurës ["N..."] sh.p.k, me seli në Prishtinë, për shkak të mos përmbushjes së kontratës, i ka propozuar gjykatës që ta aprovoje kërkesëpadinë dhe ta detyroje palën e paditur që t'ia paguaj shumën prej 20,000.00€ në emër të mos realizimit të marrëveshjes, si dhe ka kërkuar shpenzimet e procedurës.

Gjykata e shkallës së parë pas administrimit të provave ka gjetur së paditësja është biznes i cili operon në Republikën e Serbisë gjegjësisht në Preshevë dhe gjatë seancave dëgjimore ka pretenduar së në bazë të marrëveshjes gojore ka blere nga e paditura "S..." me numër të motorit ... me numër identifikimi ... viti i prodhimit 2006 në çmimin prej 20,000.00€ e cila shërben për sitjen e rërës. Nga fatura me numër ... është vërtetuar fakti se pala e paditur palës paditëse ia ka lëshuar faturën në shumën prej 10,000.00€. Nga transferi bankar me user të datës 27.02.2015 është vërtetuar se pala paditëse ka kryer pagesën e shumës prej 10,000.00€ në emër të përmbushjes së detyrimit të dhëne sipas faturës së lëshuar nga pala e paditur. Ndërsa ka refuzuar pjesën tjetër të kërkesëpadiës me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura që t'ia kthej shumën e mjeteve prej 10,000.00€ në emër të mos përmbushjes së marrëveshjes për shitjen e "S..." me numër ... dhe me numër identifikimi ... viti i prodhimit 2006 për arsye se pala paditëse nuk ka arritur që me anë të provave material të provoje para gjykatës pagesën e pretenduar në kesh në shumën prej 10,000.00€. Mbi këtë bazë ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit me arsyetimin së në këtë rast ekziston obligimi i të paditurës që paditësit t'ia paguaj shumën prej 10,000.00€.

Prandaj, gjykata e shkallës së parë duke u mbështetur në dispozitat e nenit 8 par.1, 245 par.1, lidhur me nenin 382 par.1 të LMD-së, si dhe në nenin 452.1 të LPK-së, ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimin të atakuar.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se, aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par 2. nën pikat b), g), j), k) dhe m) të LPK. Për shkak të zbatimit të rregullt të rregullave të

procedurës kontestimore dhe për shkak të konstatimit të rregullt dhe të tërësishëm të gjendjes faktike, drejtë është zbatuar edhe e drejta materiale nga ana e gjykatës së shkallës së parë. Këto shkaqe ankimore i heton dhe vlerëson gjykata e shkallës së dytë sipas detyrës zyrtare e në bazë të nenit 194 të LPK.

Kjo gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar të drejtën materiale respektivisht nenin 8 par.1 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, i cili parasheh se “ pjesëmarrësit në marrëdhëniet e detyrimeve kanë për detyrë ta zbatojnë detyrimin e vetë dhe janë përgjegjës për përmbushjen e tyre”, ndërsa me nenin 245 par.1 të LMD-së është përcaktuar se “ kreditori në raporte detyrimore është i autorizuar që prej debitorit të kerkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori është përgjegjës ta përmbushë detyrimin e tij në mënyrë të ndërgjegjshme”. Në rastin konkret nga shkresat e lëndës rezulton se duke u bazuar në marrëveshjen gojore të arritur ndërmjet palëve për shitje blerjen e “S...”, ku pala e paditur ka lëshuar faturën me numër ... në shumën prej 10,000.00€ të cilën pala paditëse e ka pranuar në mënyrë të rregullt, po ashtu duke ju referuar transferit bankar me User të datës 27.02.2015 është vërtetuar se pala paditëse ka kryer pagesën e shumës prej 10,000.00€ në dobi të palës së paditur, ndërsa duke ju referuar provave të lëndës dhe deklarimeve të palëve është vërtetuar se pala e paditur nuk ia ka dorëzuar ‘S...’ të cila ka qenë objekt i marrëveshjes gojore. Prandaj, edhe kjo gjykatë vlerëson se pala e paditur ka për detyrim kthimin e mjeteve të pranuar nga paditësja përmes transferit bankar në shumën prej 10,000.00€.

Gjykata Apelit i vlerësoi edhe pretendimet e të paditurës lidhur me atë se nuk kanë qenë në raport kontraktues me palën paditëse, mirëpo kjo gjykate këto pretendime i vlerësoi si të pa bazuar ngase nga prova e transferit bankar është vërtetuar se pala paditëse i ka transferuar shumën prej 10,000.00€ në emër të marrëveshjes gojore në mes palëve, dhe në këtë rast rezulton se paditësi dhe e paditura kanë qenë në marrëdhënie afariste për blerjen e “S...”, andaj edhe ekzistonin obligimi i të paditurës për kthimin e mjeteve të pranuar nga paditësja përmes transferit bankar në shumën prej 10,000.00€. Sipas nenit 51 të LMD-së, në qarkullimin e mallrave dhe shërbimeve nuk është e domosdoshme lidhja e ndonjë kontratës formale. Pranimi i faturës dhe pagesa e saj zëvendëson kontratën formale. Nga provat që gjenden në shkresat e lëndës rezulton se e paditësi ka pranuar faturën ... në shumën prej 10,000.00€ dhe duke ju referuar transferit bankar me User të datës 27.02.2015 është vërtetuar se pala paditëse ka kryer pagesën e shumës prej 10,000.00€.

Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet e të paditurës lidhur me gjendjen faktike, por gjeti se të njëjtat janë të pabazuara sepse gjykata e shkallës së parë në mënyrë të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike, ndërsa pretendimet e të paditurës janë në kundërshtim me provat që gjenden në shkresat e lëndës. Poashtu pretendimet ankimore bien në kundërshtim njëra me tjetrën sepse e paditura në njërin anë e kundërshton pranimin e pagesën për objektin kontestues ndërsa në anën tjetër thekson se sendi -“s...” i është dorëzuar në posedim paditësit dhe ka përfunduar detyrimi i të paditurës për dorëzimin e sendit, por persona tjerë e kanë penguar paditësin ta marrë sitën. Ky pretendim përveç kontradiktor është edhe pa asnjë bazë ligjore sepse për tu konsideruar se sendi është dorëzuar ai duhet të i dorëzohet blerësit pa asnjë të metë juridike dhe faktike.

Numri i lëndës: 2020:920220
Datë: 30.04.2021
Numri i dokumentit: 01753254

Prandaj bazuar në të lartcekurat, kjo gjykatë vlerëson se aktgjykimi i atakuar i gjykatës së shkallës së parë nuk ka të meta për shkak të së cilave nuk mund të vlerësohet ligjshmëria e tij, dispozitivi i aktgjykimit është i kuptueshëm, nuk është në kundërtënie me vetveten ose me arsyet e aktgjykimit dhe se aktgjykimi përmban arsye të mjaftuara dhe bindëse për gjendjen faktike dhe juridike, për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilat në tërësi i aprovon edhe Gjykata e Apelit.

Nga të cekurat u vendos si në dispozitiv në bazë të nenit 195.1 nën pikën d), e lidhur me nenin 200 të LPK-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS,
Ae.nr.281/2019, dt.02.04.2021

KRYETARI I KOLEGJIT,
Mahir Tutuli, d.y.

